



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. _____ prot.

Korçë, më _____.

RELACION**PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR 58 DATË 25.4.2024 “PËR DETAJIMIN DHE PËRDORIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR MBROJTJEN CIVILE**

Me shkresën nr. 446/2, datë 20.02.2024, “Mbi fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, nga Ministria e Mbrojtjes, (AKMC), fondi i kushtëzuar nga buxheti i shtetit të vitit 2024, për Bashkinë Korçë, është në vlerën 19,445,090 lekë. Ky fond nuk trashëgohet në vitin pasardhës. Me VKB-në, nr. 58, datë, 25.04.2024, “Për detajimin dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen Civile”, u miratua detajimi dhe përdorimi i këtij fondi. Pas kryerjes së procedurave të prokurimit kanë mbetur fonde në vlerën 1,420,130 lekë. Nisur dhe nga kërkesa e Ndërrmarrjes së Shërbimeve Publike dhe shqetësimet e hasura gjatë verës gjatë angazhimit të punonjësve të NjA-ve, është menduar që ky fond të përdoret për blerje veshje pune dhe vegla pune, për punonjësit që angazhohen në situata të ndryshme të fatkeqësive natyrore. Ky ndryshim është i bazuar në VKM-në, nr, 414, datë, 08.07.2021, i ndryshuar dhe kërkojmë miratimin e ndryshimeve të detajuara sipas tabelës së mëposhtme nga Këshilli Bashkiak:

Tabela me shpenzimet e parashikuara nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit.

/lekë

Nr.	Zërat e shpenzimeve të fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile	Shuma e parashikuar në lek.	Ku bazohet në VKM-në. nr. 414, datë, 08.07.2021.	Pakësohet	Shtohet	Bëhet
1	Shpenzime për blerje kripe për Emergjencat dimërore.	1,002,770	Pika 3.1, gërma, g.	79,610		923,160
2	Shpenzime për blerje pajisje profesionale që ju shërbejnë strukturave të EC, pika 3, gërma “g”	7,942,320	Pika 3.1, gërma, g.	194,152		7,747,800
3	Blerje automjete: Minieskavatorë me goma, me kovë para me sistem hidraulik. viti 2022-2023, 2 copë.	10,500,000	Pika 3.1, gërma, ë, e ndryshuar me VKM-në, Nr, 290, datë, 17.05.2023, “Për një ndryshim në vendimin 414, datë 08.07.2021”.	1,146,000		9,354,000

4	Shpenzime për blerje veshje pune për përdorim për EC.		Pika 3.1, gërma, g.		1,147,920	1,147,920
5	Shpenzime për blerje mjete pune për EC,		Pika 3.1, gërma, g.		272.210	272,210
Shpenzime në total		19,445,090		1,420,130	1,420,130	19,445,090

Bazuar në Ligjin, 45/2019, “Për Mbrojtjen Civile”, Ligjin 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, VKM-në, nr, 414, datë, 08.07.2021, “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile”, Ligjin nr. 9936, datë, 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin, nr. 68, datë, 27.04.2017, “Për financat e Qeverisjes Vendore, ligjin 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, Udhëzimin nr.9, datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar , Udhëzimin Plotësues nr. 1 datë 24.1.2024 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”, si dhe VKB nr. 58, datë, 25.04.2024, “Për detajimin dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar për Mbrojtjen Civile”, kërkojmë nga Këshilli Bashkiak të miratojë ndryshimin e detajimit dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar për vitin 2024 sipas tabelës së mësipërme.


Përgj. Sek. të Em. Civile

Arjan Qasolli



Drejtoria e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe M.F.K


Valbona Ziko



Drejtoria e Përgjithshme Juridike

dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

Anxhela (Dishnica) Qeramixhi



KRYETARI I BASHKISË

Sotiraq Filo

